

PUNA DHE DREJTËSIA SOCIALE

# BOTA E PUNËS NË KOHË PANDEMIE

Krizë dhe mundësi

**Edlira Xhafa dhe Liri Kuçi**  
Nëntor 2020



Përtej situatës kritike në sistemin shëndetësor, Covid-19 shpërfaqj dhe përkeqësoi krizën e thellë në botën e punës dhe dobësitë strukturore të modelit zhvillimor të këtyre tri dekadave.



Përballë kësaj krize sistemore, paketat qeveritare qenë tërësisht të pamjaftueshme për të zbutur sadopak varfërinë në vend. Përfituesit më të mëdhenj rezultuan kompanitë e mëdha koncesionare.



Covid-19 ofron një mundësi historike për një model që orientohet drejt nevojave bazë të shoqërisë, punësimit dinjitoz, forcimit të rezistencës ndaj krizave dhe transformimit ekologjik të ekonomisë.

PUNA DHE DREJTËSIA SOCIALE

# BOTA E PUNËS NË KOHË PANDEMIE

Krizë dhe mundësi

# Përmbajtja

<b>HYRJA</b>	5
<b>1. IMPAKTI I COVID-19 NË SHQIPËRI</b>	6
<b>2. PËRGJIGJJA E QEVERISË RAMA</b>	10
2.1. Problemet kryesore të skemave	10
<b>3. COVID-19: EKSPozIM DHE THELLIM I KRIZËS NË BOTËN E PUNËS</b>	13
<b>4. NJË MODEL ZHVILLIMOR PËRTEJ KRIZËS SË COVID-19</b>	15
4.1. Ndërtimi i një sistemi të fortë shëndetësor	15
4.2. Forcimi i skemës së mbrojtjes sociale dhe ekonomike	16
4.3. Rritja e mbrojtjes për punëtorë/et dhe të drejtat e tyre	16
4.4. Masa që shënjestrojnë gratë në veçanti	17
4.5. Transformimi dhe demokratizimi i ekonomisë	18
4.6. Mobilizimi i burimeve financiare për transformimin ekologjik Të ekonomisë	19
<b>BIBLIOGRAFIA</b>	22



# HYRJE

Kjo analizë fokusohet në impaktin e Covid-19 në botën e punës në Shqipëri. Cilësia problematike e të dhënave zyrtare kufizon mundësinë e një analize të plotë të këtij impakti edhe pse raportet në media të ndryshme flasin për rritje të papunësisë, varfërisë dhe abuzimit me të drejtat e punëtorëve. Kjo situatë alarmante bëhet më e qartë kur merren në konsideratë treguesit kryesorë të ekonomisë si edhe masat e pamjaftueshme të ndërmarra gjatë kësaj periudhe nga qeveria. Përtej impaktit të pandemisë, kjo analizë argumenton se rrënjët e krizës së thellë, me të cilën po përballlet sistemi shëndetësor, ekonomia dhe

bota e punës gjatë kësaj kohe gjenden në modelin zhvillimor të këtyre tri dekadave. Për këtë arsye, pjesa më e madhe e kësaj analize i dedikohet diskutimit të disa prej politikave kryesore të cilat do të jenë kritike jo vetëm për t'u përballur me sfidat e shkaktuara nga Covid-19, por sidomos për të tejkaluar krizën e këtij modeli zhvillimor. Ndërsa formulimi i një pakete të plotë politikash do të kërkojë angazhimin e ekspertëve të fushave të ndryshme, diskutimi në këtë analizë fokusohet në parimet për formulimin e këtyre politikave dhe identifikimin e disa prej burimeve për financimin e tyre.

## 1

# IMPAKTI I COVID-19 NË SHQIPËRI

Ajo çka filloi si një përgjigje ndaj Covid-19, tregoi haptazi krizën e thellë të sistemit shëndetësor në Shqipëri dhe u kthye në një goditje fatale për ekonominë dhe botën e punës.

Tri dekada keqmenaxhimi dhe reformash, që nxisin logjikën e tregut në shëndetësi, e kanë çuar sistemin në gjendje kritike: Shqipëria renditet e fundit në rajon përsa i përket kapaciteteve shëndetësore në klinika, spitale e qendra të kujdesit shëndetësor, si edhe marrjes së kujdesit shëndetësor (World Bank 2020a: 8); ajo ka më pak se 3 shtretër për 1,000 banorë, çka është më pak se gjysma e mesatares rajonale (World Bank 2020b: 14) dhe vuan nga mungesa të theksuara të mjeteve bazë mbrojtëse për personelin shëndetësor.<sup>1</sup> Përballë kësaj situatë alarmante në sistemin shëndetësor, por edhe një katastrofë urbane me ndërtime pa kriter, trotuare gjithmonë e më të ngushta e tkurje të parqeve publike e zonave të gjelbra, shteti shqiptar deklaroi një karantinim thuajse të plotë për të evituar kolapsin e sigurt të sistemit shëndetësor.

Karantinimi konsistoi në mbylljen e pjesës më të madhe të aktiviteteve ekonomike, të konsideruara joesenciale, mbyllje që zgjati që prej regjistrimit të rasteve të para me koronavirus (9 mars 2020) deri në fillim të qershorit. Masat e marra për të evituar përhapjen e virusit i dhanë një goditje të fortë ekonomisë së sfillitur shqiptare. Sipas Institutit të Statistikave (INSTAT), në tremujorin e dytë të 2020, produkti i përgjithshëm bruto ra me 10.23% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të shkuar (2020a). Siç shihet edhe në Figurën 1, sektorët më të prekur ishin shërbimet (tregtia, transporti dhe hoteleria) me një rënie 26.35% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të shkuar; aktivitetet financiare dhe të sigurimit (21.68%); arte, argëtim çlodhje (19.56%); aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike (19.45%); industritë nxjerrëse e përpunuese (13.14%); dhe ndërtimi (10.93%). Ndërkohë,

konsumi i përgjithshëm, i cili përbën edhe peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, u ul me 7.57% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Qartazi, tkurja e kontributit të sektorëve në ekonomi ka një efekt të drejtpërdrejtë në punësim, ndonëse këtu panorama është shumë më komplekse (Figura 1). Sipas INSTAT, në tremujorin e dytë të këtij viti shkalla e papunësisë vlerësohet të jetë 11.9%, ose vetëm me 0.4% më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019 dhe 0.5% më shumë krahasuar me tremujorin e parë të 2020 (2020b). Ndërkohë, INSTAT nuk ofron të dhëna për impaktin në punësim në sektorë të tjerë të prekur nga Covid-19 si p.sh. arte, argëtim, çlodhje dhe ndërtim. Gjasat janë që impakti të jetë i fortë, veçanërisht për arte, argëtim e çlodhje, që janë prekur drejtpërdrejt nga mbyllja e aktiviteteve përgjatë periudhës së karantinimit e më tej.


Vlerësimet e papunësisë së INSTAT-it për periudhën e pikut të pandemisë ngrënë shumë pikëpyetje. *Së pari*, është e paqartë se përse ritmi i uljes së punësimit në sektorin e shërbimeve (3.4%) është më i vogël se sektorët e tjerë si p.sh. industria dhe bujqësia (3.7% secila). INSTAT nuk ofron ndonjë shpjegim për faktin, se ndonëse ky është sektori me tkurrjen më të madhe të kontributit në Prodhimin e Përgjithshëm Bruto (PPB),<sup>2</sup> rënia e punësimit është më e vogël se në bujqësi, ku sipas raportimeve të anketës së Albania Investment Council në periudhën 28 mars – 5 maj 2020, puna vazhdoi plotësisht ose pjesërisht në 81% të sektorit (2020: 3).

*Së dyti*, shifrat e INSTAT janë problematike veçanërisht duke pasur parasysh efektin e fortë të krizës në sektorë të integruar në ekonominë globale e rrjedhimisht edhe në punësimin në këta sektorë. Statistikat e INSTAT, tregojnë se krahasuar me një vit me parë, eksportet e mallrave në tetëmujorin e parë të 2020, u ulën me 15.4% dhe importet e mallrave u ulën me 12.3% (2020d: 1). Jo vetëm mungesa e aksesit në tregjet ndërkombëtare, por edhe ulja e importeve ka ndikim të drejtpërdrejtë në

1 Raportime të ndryshme në media treguan qartazi mungesën totale të mjeteve më bazike për personelin shëndetësor, përfshirë edhe alkool për disinfektim: <https://gazetaora.com/2020/03/06/plas-skan-dali-publikohet-audio-regjistrimi-ku-drejtoresha-e-qendres-shendetesore-i-ben-presion-mjeteve-dhe-infermiereve/>

2 Sektori ka gjithashtu numrin më të madh të të punësuarve, 43.5% sipas INSTAT (2020c: 1)

Figura 1  
**Impakti i pandemisë mbi ekonominë dhe punësimin**



ekonominë shqiptare. Sipas anketës së Albania Investment Council, 69% e kompanive deklarojnë, se janë dëmtuar seriozisht pasi janë shumë të varura nga importet (2020: 3). Ky efekt negativ është akoma më i fortë në sektorin e industrisë ku 83% e kompanive deklarojnë se varen plotësisht nga importet.

Së fundmi, vlerësimet e INSTAT bien ndesh me raportimet nga organizata të ndryshme dhe mediat. Anketa e Albania Investment Council raporton se 47% e ndërmarrjeve e ndaluan plotësisht aktivitetin (2020: 3). Në veçanti, sektori i turizmit pësoi një mbyllje të aktiviteteve deri në 75% (Ibid.). Më veçanërisht për punësimin, anketa tregon se pushimet nga puna janë aplikuar gjerësisht gjatë kohës së pandemisë. Kështu, 67% e kompanive (më së shumti ndërmarrje të mëdha) përdorën largimet nga puna dhe 33% e tyre përdorën lejet e zakonshme dhe punë nga shtëpia (kryesisht shërbimet). Ndërkohë, anketa e sindikatës Solidariteti<sup>3</sup> dhe Monitor (2020) raportojnë pushime nga puna në sektorin *call center*.

Një rritje kaq e vogël e shifrave zyrtare të papunësisë përballë një krize shumëdimensionale, si koronavirusi, shpjegohet në një farë mënyre nga përkufizimi i punësimit i aplikuar nga INSTAT, përkufizim i cili ka tendencën që të rrisë artificialisht numrin e të punësuarve, duke konsideruar të punësuar edhe ata/o që kanë punuar qoftë edhe një orë në javën e referencës.<sup>4</sup> Ndërkohë, një ndër kriteret për të përcaktuar shkallën e papunësisë është të kërkuarit punë në mënyrë aktive.<sup>5</sup> Kështu, pavarësisht se sipas të dhënave të detajuara të Anketës Tremujore të Forcave të Punës të INSTAT (2020e) për tremujorin e II-të 2020, numri i të punësuarve ka rënë me 33,235 krahasuar me tremujorin e parë të 2020, INSTAT deklaroi, se papunësia është rritur vetëm me 0.5%, pasi vetëm 1,423 vetë plotësojnë kriteret për t'u konsideruar të papunë. Shifrat e INSTAT për papunësinë në tremujorin e II-të duhen marrë me shumë rezerva, jo vetëm për përkufizimet

problematike të aplikuara nga INSTAT, por edhe sepse të dhënat i referohen periudhës së karantinimit (tremujori i II-të), kur qeveria aplikoi skemën e ndihmës, çka mund të ketë "fshehur" përkohësisht krizën e humbjes së vendeve të punës në Shqipëri.

Përveç heqjeve nga puna, punëtorët/et janë përballur edhe me masa të tjera që prekin orët e punës dhe rrjedhimisht edhe të ardhurat. Kështu, kompanitë *call center* iu kanë pezulluar punonjës/eve një pjesë të kontratave të punës, iu kanë dhënë pushime të detyruara pa pagesë ose iu kanë pakësuar orët e punës pa shpjegim. Në Tiranë, Durrës dhe Shkodër, kompanitë *call center* i detyruan punëtorët/et të nënshkruajnë kontrata 4-orëshe; në të kundërt do të mbeteshin pa punë, ose vetëm me 2 javë punë në muaj. Për punonjësi/et që punuan nga shtëpia, kompanitë nuk paguan as internetin në banesë e as shtesën në konsumin e energjisë elektrike, të cilat rëndojnë më shumë mbi pagën e pakësuar të punonjësve të *call center-ave*.<sup>6</sup> Këta/o punëtorë/e u përballën edhe me problematika të tjera, si turne të zgjatura apo ngarkesë ekstra në procesin e punës (Monitor 2020).

Duke qëndruar hapur, kompanitë e fasonerive, minierave dhe *call center-ave* u bënë në shumë raste edhe vatrë me të mëdha të përhapjes së virusit, veçanërisht për shkak të mos-zbatimit nga kompanitë të protokolleve të sigurisë ndaj Covid-19 (maska, disinfektantë, distancë fizike, etj.). Në minierat e Zonës D dhe AlbChrome u raportuan shumë raste të mungesës së maskave, apo të transportit të organizuar sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik.<sup>7</sup> Të përballur me kufizim të skemave të mbështetjes nga qeveria për vetëm ato kompani që ishin të mbyllura, punëtorët/et e fasonerive, minierave dhe *call center-ave* u detyruan të punojnë për të siguruar mbijetesën e familjeve të tyre pavarësisht rrezikut të lartë të infektimit nga Covid-19. Punonjësi/et e shërbimit dhe pastrimit gjithashtu vazhduan punën, shpesh pa masat bazë të sigurisë.<sup>8</sup> Mosndërprerja e punës për asnjë ditë gjatë kulmimit me rastet e prekura nga koronavirusi, teksa në

3 Dosja.al. Punëtorët e kompanive Call centers të nënvlerësuar: Në rrethe paguhen më pak se në Tiranë. Aksuar më 15 tetor 2020, nga: <https://dosja.al/punetoret-e-kompanive-call-centers-te-nenvleresuara-gjate-pandemise-ne-rrethe-paguhen-me-pak-se-ne-tirane/>

4 Sipas INSTAT, personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitim gjatë javës së referencës konsiderohen të punësuar. Konsiderohen të tillë edhe ata për të cilët (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor stinor ose (b) personi merr 50 për qind ose më shumë të pagës; (3) të vetë-punësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetë-konsum, janë konsideruar të punësuar.

5 Të papunë konsiderohen personat që ishin: a) pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi; b) aktualisht të gatshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës); c) duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të vetin) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj)

6 Fax web. U ulën pagat, një mori vendesh pune janë shkurtuar", punëtorët e kompanive Call Center të nënvlerësuar gjatë pandemisë. Aksuar në datë 30 Gusht 2020 nga: <https://www.faxweb.al/ulen-pagat-nje-mori-vendesh-pune-jane-shkurtuar-punetoret-e-kompanive-call-center-te-nenvleresuara-gjate-pandemise/>

7 Reporter. Covid-19, minatorët e Bulqizës mbeten në punë edhe gjatë pandemisë. Aksuar më 16 tetor 2020, nga: <https://www.reporter.al/covid-19-minaret-e-bulqizes-mbeten-ne-pune-edhe-gjate-pandemise/>; -Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës (SMBB). Vazhdon puna në minierën e Albchrome, pa masa mbrojtëse për punëtorët. Aksuar më 17 qershor, 2020 nga: <https://www.facebook.com/MinaretSMBB/posts/157235972407016>; -Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës. Infektohen me Covid-19 punonjës në minierën e Albchrome në Bulqizë. Aksuar më 23 Gusht 2020, nga: <https://www.facebook.com/MinaretSMBB/photos/a.103075584489722/193410505456229>

8 Reporter. Punonjësit e pastrimit në Lezhë pa mjete mbrojtëse, kryebashkiaku; S'jane te rrezikuar. Aksuar më 15 tetor 2020, nga: <https://www.reporter.al/punonjesit-e-pastrimit-ne-lezhe-pa-mjete-mbrojtese-kryebashkiaku-sjane-te-rrezikuar/>



anën tjetër viheshin gjoba për qarkullimin e qytetarëve/ederi në dyqanin e lagjes, tregojnë për hendekun e madh midis formalitetëve qeveritare dhe realitetit të frikshëm për ata/o mijëra punëtorë/e, që vazhduan të punonin duke u përballur çdo ditë me rrezikun e infektimit personal dhe të familjeve të tyre. Ndërkaq, është e paqartë se ç'po ndodh me një tjetër kategori si punëtorët e shpërndarjes së ushqimeve dhe produkteve të tjera nëpër banesa.<sup>9</sup>

Nje fenomen tjetër shqetësues përgjatë pandemisë ka qenë numri i lartë i të aksidentuar/ave në punë, e në shumë raste me pasojë vdekjen. Pavarësisht mbylljes së ekonomisë në një masë të madhe, aksidentet kanë vazhduar. Kështu, sipas një raportimi të Inspektoriatit të Punës, vetëm në 6 muajt e parë të vitit janë regjistruar 78 aksidente në punë, nga të cilat 16 kanë rezultuar në vdekjen e punëtorëve.<sup>10</sup> Sektorët më të prekur janë: ndërmarrjet prodhuese (20), minierat (16) dhe ndërtimi (13).

Në miniera, si Albchrome, punëtorët nuk morën asnjë pagesë shtesë për punë me rrezik të lartë infeksioni. Në disa miniera të tjera, si në galeritë e Zonës D në Bulqizë dhe minierat e zonës së Batrës, minatorëve nuk iu është dhënë paga pavarësisht se puna ka vazhduar. Praktika të mospagimit për punën e bërë u raportuan edhe në fasoneri,<sup>11</sup> sektor i cili dominohet nga gratë (Arqimandriti et al. 2016).

Përballë kësaj situatë dramatike në botën e punës, qeveria përdori pandeminë për të kriminalizuar të drejtën për veprime kolektive në raste të shkeljeve të së drejtave të punëtorëve/eve.

Ndoshta në rastin e vetëm në botë, kufizimi i lirive sindikale nga ana qeverisë u mbështet edhe nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH). Kjo atmosferë pasigurie dhe pamundësie për të protestuar dhe organizuar po përdoret për të legjitimuar e vazhduar me abuzimin me të drejtat e punëtorëve/eve.

Ndërkaq, disa grupe shoqërore janë prekur akoma më shumë. Kështu, sipas një ankete mbi impaktin e pandemisë në 10 vende të rajonit të realizuar nga UN Women,<sup>12</sup> ndër të vetëpunësuarit, gratë u prekën më shumë se burrat; ato u detyruan të reduktojnë orët e punës për t'u kujdesur për fëmijët dhe punët shtëpiake (2020a). Gjithashtu, një numër shumë i lartë grash raportuan rritje të punës së papaguar për kujdes për anëtarët e familjes (72%) dhe për punë shtëpiake (76%) (Ibid.: 22, 25). Gjithashtu, anketa tregoi se gratë në Shqipëri kanë përjetuar nivele më të larta stresi psikologjik se burrat, por edhe se gratë e tjera në rajon (Ibid.: 37). Ashtu si edhe në vende të tjera, gjatë periudhës së pandemisë gratë shqiptare u përballën edhe me rritje të dhunës në familje (Ibid.).

Komuniteti rom dhe egjiptian është goditur gjithashtu rëndë. Të lënë jashtë skemave qeveritare, këta/o punëtorë/e u përballën edhe me masa të repta karantinimi që kufizuan mundësinë e tyre për të ushqyer veten dhe familjet.<sup>13</sup> Ndërkaq, media të ndryshme hodhën dritë mbi situatën tragjike të refugjatëve të strehuar në Shqipëri, ku disa prej tyre u detyruan të lypin rrugëve për të mbijetuar.<sup>14</sup>

9 Reporter. Në dukje në lulëzim, biznesi i shpërndarjes online i mban dyert hapur për mbijetesë. Aksuar më 18 tetor 2020, nga: <https://www.reporter.al/ne-dukje-ne-lulezim-biznesi-i-shperndarjes-online-i-mban-dyert-hapur-per-mbijetes/>.

10 Shqiptarja.com. Inspektorati i Punës: Në 6 muaj 78 aksidente në punë, 16 humbën jetën! Punëtorët e ndërtimit dhe të fabrikave më të rrezikuar. Aksuar më 15 tetor 2020, nga: <https://shqiptarja.com/lajm/inspektorati-i-punes-ne-6-muaj-78-aksidente-ne-pune-16-humben-jeten-punetoret-e-ndertimit-dhe-te-fabrikave-me-te-rrezikuar>

11 Shqiptarja.com. Edhe në vrimë të miut të futet pronarin do ta djeg të gjallë! Puntoret e fasonerisë pa pagë lufte. Tatimet: Biznesi i ka hequr nga sigurimet. Aksuar më 15 tetor 2020, nga: <https://shqiptarja.com/lajm/edhe-ne-vrime-te-miut-te-futet-pronarin-do-ta-djeg-te-gjalle-puntoret-e-nje-fasonerie-ne-kece-proteste-para-drejtorise-tatimeve-duam-te-hame>

12 Azerbajxhani, Bosnia dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Kazakistani, Kosova, Kirgistani, Maqedonia e Veriut, Republika e Moldavisë, Shqipëria dhe Turqia.

13 Reporter. Pa punë dhe pa ndihma: Karantina thëllon varfërinë e komunitetit rom dhe egjiptian. Aksuar më 15 tetor 2020, nga: <https://www.reporter.al/pa-pune-dhe-pa-ndihma-karantina-thellon-varferine-e-komunitetit-rom-dhe-egjiptian/>

14 Fakte.al. Kush përgjigjet për refugjatët e paligjshëm nga Lindja e Mesme në Tiranë? Aksuar më 12 tetor 2020, nga: <https://fakte.al/kush-pergjigjet-per-refugjatet-e-paligjshem-nga-lindja-e-mesme-ne-tirane/>; Citizens channel. Aksuar më 12 tetor 2020, nga: <https://citizens-channel.com/2020/07/16/refugjatet-e-huaj-ne-shqiperi-gjate-izolimit-covid-19-mes-kushteve-te-veshtira-dhe-pamundesise-per-te-levizur/>

## 2

## PËRGGJIGJJA E QEVERISË RAMA

Në përgjigje të Covid-19, qeveria akordoi dy paketa financiare për të mbështetur qytetarë/et dhe bizneset, miratoi buxhet shtesë për sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, si dhe shtoi Fondin Rezervë për shpenzime të tjera të nevojshme dhe të paparashikuara. Paketa e parë konsistoi në ndihmë financiare për të punësuarit në biznesin e vogël që mbyllën aktivitetin për shkak të pandemisë, çka përfshiu të vetëpunësuarit/at, punonjësi/et e papaguar të familjes, si edhe të punësuarit/at në personat fizikë tregtarë dhe në personat juridikë. Kjo paketë parashikoi edhe dyfishim të ndihmës financiare dhe të asistencës për papunësinë. Paketa e dytë u fokusua në: 1) subvencionim për punonjësi/et e larguar e aktualë të bizneseve me të ardhura nën 14 milionë lekë, të mbyllura me urdhër të qeverisë; 2) mbështetje për të larguarit/at nga puna në periudhën 1 mars – 17 maj në të gjitha subjektet (pavarësisht nëse u mbyllën apo jo); 3) subvencionim për të gjithë punonjësi/et e bizneseve me të ardhura nën 14 milionë lekë (me përjashtim të profesioneve të lira, tregtise, farmacive, përfituesi/eve së pagës së luftës së paketës së I-rë); 4) subvencionim i pagës së luftës për punonjësi/et e hotelierisë në sektorin e turizmit; 5) mbështetje për punonjësi/et e Rafinerisë së Ballshit; si edhe 6) ndihmë financiare për aplikuesi/et e ndihmës ekonomike, të cilët rezultojnë aplikues/e, por nuk janë përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit të ndihmës ekonomike.

Gjithashtu, qeveria ofroi përdorimin e dy instrumenteve të Garancisë Sovrane. Ndërsa instrumenti i parë (11 miliardë lekë) parashikonte pagesat e punonjës/eve të prekur nga pandemia për tre muaj, subvencionim të interesit nga qeveria dhe një periudhë pa shlyerje të principalit për 6 muaj, i dyti (15 miliardë lekë) parashikonte aplikimin për nevoja në kapital qarkullues dhe investime, si dhe ofronte kushte preferenciale financimi, afat shlyerje deri në 5 vjet, ndarje të rrezikut me bankat dhe periudhë pa shlyerje të principalit për 6 muaj.

Skema përfshiu edhe shtyrjen e tatim-fitimit për bizneset deri në fund të shtatorit dhe për sektorët fasoneri, turizëm, *call center* e biznes i vogël deri në fund të dhjetorit 2020.

### 2.1 PROBLEMET KRYESORE TË SKEMAVE

Një analizë e hollësishme e këtyre paketave do të kërkonte informacione më të plota, nga sa ofron Ministria e Financave dhe Ekonomisë në faqen e saj zyrtare.<sup>15</sup> Pavarësisht, raportimet e ndryshme tregojnë se skema e mbështetjes ka mangësi të dallueshme përsa i përket mbulimit dhe nivelit të ndihmës.

Së *pari*, skema përjashton një numër shumë të madh punëtorë/esh. Kështu, të përjashtuar rezultuan punëtorë/et informalë dhe të punësuarit/at në sektorin bujqësor, të cilët përfaqësojnë përkatësisht 37.4% (World Bank 2018) dhe 36.4% (INSTAT 2020c: 1) të të gjithë të punësuarve .

Së *dyti*, mbështetja financiare për punëtorë/et që përfituan nga skema ishte shumë e ulët: të vetëpunësuarit/at dhe të punësuarit/at në biznesin e vogël të mbyllur me urdhër qeveritar morën “pagën e luftës” prej 26,000 lekë/muaj për një periudhë tremujore; të papunë/at dhe ata/o që trajtohen me ndihmë ekonomike përfituan vlerën e dyfishtë; dhe 10,000 të punësuarit/at në sektorin e turizmit, 66,000 të punësuarit/at në biznesin e madh, por që humbën punën dhe 100,000 të punësuarit/at në biznesin e vogël të prekur nga pandemia morën vetëm një pagesë 40,000 lekë për tre muajt e mbylljes së këtyre njësive ekonomike (Porta Vendore 2020). Sipas këtij vlerësimi, nëse zbritet nga paketat qeveritare Garancia Sovrane, atëherë fondi i vënë në dispozicion për të mbështetur të punësuarit/at si edhe grupet që trajtohen me pagesë papunësie dhe ndihmë ekonomike është më i vogli krahasuar me vendet e rajonit.<sup>16</sup>


Së *treti*, përveç nivelit shumë të ulët të ndihmës, raportime në media të ndryshme tregojnë se punëtorë/et në sektorë të ndryshëm kanë pasur probleme në përfitimin e

<sup>15</sup> Ministria e Financave dhe Ekonomisë. 2020. Raporte për Covid-19. Aksuar më 12 tetor 2020, nga: <http://financa.gov.al/raporte-per-covid-19/>

Për shembull, në tabelën e përditësuar në datë 3 shtator 2020, shifra disbursimi i janë caktuar edhe qytetarëve që janë ankuar pa asnjë shpjegim nëse ankesa e tyre ishte adresuar.

<sup>16</sup> Kështu, ndërsa vlera e paketës financiare në raport me PPP në Shqipëri është vetëm 1.8%, në Serbi kjo shkon 11%, në Maqedoninë e Veriut 3.6%, e në Kosovë 3% (Porta Vendore 2020).

Figura 2

**Përfituesit e Garancisë Sovrane sipas sektorëve: miratuar dhe disbursuar**

Riprodhuar nga autorët, bazuar në të dhënat e siguruar nga BIRN (Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë)  
 Shënim: Fondi i miratuar për Hoteleri/Turizëm është 0.3%

ndihmës.<sup>17</sup> Kjo mund të jetë direkt e lidhur me mungesën e mekanizmave për shpërndarjen e pagesave, por edhe të kapaciteteve të administratës shtetërore për të realizuar shpërndarjen.

Së fundmi, kushtet e Garancisë Sovrane duket se nuk i kanë kushtuar ndonjë vëmendje nevojave dhe veçantive të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat dominojnë sektorët më të prekur nga kriza. Sipas të dhënave të siguruar nga Reporter (Figura 2), sektorit të hoteleri/turizëm i është akorduar vetëm 0.3% e fondit të Garancisë Sovrane dhe sektorit të fasonerisë 16% (2020a). Në kontrast, përfituesit më të mëdhenj të paketave qeveritare duket të jenë kompanitë e mëdha, njëherazi edhe fituese të koncesioneve, kryesisht gjatë mandatit të qeverisë Rama. Deri në fund të muajit maj, këto kompani kishin përfituar 48% të fondeve të Garancisë. Lista e përfituesve të mëdhenj kryesohet nga Spitali Amerikan dhe kompania AlbChrome, pjesë e grupit Balfin. Nga Garancia Sovrane kanë përfituar edhe kompani të tjera të këtij grupi si Neptun, Fashion Group Albania dhe Kid Zone. Renditja vazhdon me të tjerë koncesionarë në sektorin e naftës, si Bankers Petroleum dhe Kastrati, si edhe dhe koncesionari në fushën e ndërtimit, “Gjoka Konstruksion”.

Ajo çka bie në sy qartazi, është se edhe pse grupi i koncesionarëve ka përfituar tri herë më shumë se kompanitë në sektorin e fasonerisë, nivelet e disbursimit, janë shumë më të ulëta. Më shumë se nevojë për likuiditet këto kompani, disa prej të cilave të njohura për shkelje flagrante të të drejtave të punëtorëve dhe mosrespektim të protokolleve të ruajtjes nga koronavirusi, si p.sh. AlbChrome, e kanë përdorur pandeminë si një mundësi të artë për të përfituar nga kushtet lehtësuese të këtyre kredive. Ndërkaq, sipas kryetarit të Dhomës së Tregëtisë, Nikolin Jaka, arsyeja e numrit të ulët të aplikimeve për fonde të Garancisë Sovrane nga kompanitë është e lidhur me frikën e pamundësisë për të shlyer kredinë, dhe rrjedhimisht të konfiskimit të biznesit.<sup>18</sup>

Kjo lloj qasjeje konfirmohet edhe nga anketa e Albania Investment Council (2020), sipas së cilës përdorimi i të ardhurave të akumuluar dhe ulja e kostove përmes shkurtimit të vendeve të punës apo uljes së prodhimit janë ndër strategjitë kryesore që kompanitë po konsiderojnë për t’u përballur me krizën. Kjo do të thotë se problemet e modelit të Garancisë Sovrane duket të kenë kufizuar ndjeshëm rolin, që këto fonde do të duhej të luanin në zbutjen e krizës ekonomike dhe të humbjes së punësimit.

17 Monitor 28. Shqipëria, e fundit në rajon për pagesat direkte gjatë pandemisë. Aksesuar më 15 tetor 2020, nga: <https://www.monitor.al/monitor-ekonomi-28-shqiperia-e-fundit-ne-rajon-per-pagesat-direkte-gjate-pandemise/>  
ABC News. 60 punëtorë të pa punë në Korçë, nuk përfitojnë as pagën e luftës, Tatimet: Të aplikojnë për asistencë. Aksesuar më 15 tetor 2020, nga: <https://abcnews.al/60-punetore-te-pa-pune-ne-korce-nuk-perfitojne-as-pagen-e-luftes-tatimet-te-aplikojne-per-asistence/>  
Porta Vendore. Paga e luftës”, 8 mijë persona skualifikohen nga sistemi. Aksesuar më 15 tetor 2020, nga: <https://portavendore.al/2020/04/29/paga-e-luftes-8-mije-persona-skualifikohen-nga-sistemi/>  
Monitor. Tre arsyet pse po u refuzohet ndihma financiare të punësuarve të bizneseve të vogla (vetëm një e treta do përfitonin). Aksesuar më 15 tetor 2020, nga: <https://www.monitor.al/tre-arsyet-pse-po-u-refuzohet-ndihma-financiare-te-punesuarve-te-bizneseve-te-vogla-vetem-nje-e-treta-do-perfitonin/>  
Monitor. Si po ndihmohet biznesi me paketat financiare anti-COVID-19; Garancia e dytë sovrane e pavlefshme. Aksesuar më 15 tetor 2020, nga: <https://www.monitor.al/si-po-ndihmohet-biznesi-me-paketat-financiare-anti-covid-19-garancia-e-dyte-sovrane-e-pavlefshme/>

18 Lapsi. Paketat anti-COVID/ Shqipëria e fundit në rajon për mbështetjen direkte. Aksesuar më 15 tetor 2020, nga: <https://lapsi.al/2020/05/08/paketat-anti-covid-shqiperia-e-fundit-ne-rajon-per-mbeshtetjen-direkte/>

## 3

## COVID-19: EKSPozIM DHE THELLIM I KRIZËS NË BOTËN E PUNËS

Pandemia shpërfaqti e përkeqësoi problemet strukturore të botës së punës në Shqipëri. Prandaj, një vlerësim më i plotë i intensitetit të krizës së shkaktuar nga koronavirusi nuk mund të bëhet i shkëputur nga këto probleme.

Kështu, infektimet me koronavirus në vendin e punës por edhe aksidentet e shumta në punë gjatë periudhës së pandemisë janë të lidhura drejtpërsëdrejti me dobësitë e sistemit të mbrojtjes dhe shëndetit në punë. Sistemi aktual, i cili bazohet në sjelljen e punëtorëve/ëve ndaj sigurisë në punë (*behavioural-based safety*), i ka nxjerrë gjithmonë ata/o fajtorë për aksidentet në punë. Ndërkaq, strukturat e përcaktuara me ligj si përgjegjëse për politikën dhe zbatimin e sigurisë në punë janë jofunksionale. Kështu, sipas një interviste të fundit të Presidentit të KSSH-së, Kol Nikollaj, Këshilli Ndërmintor i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, i cili është një këshill tripalësh i kryesuar nga kryeministri, nuk funksionon; prania e mjekëve të punës në ndërmarrje, e cila është një detyrim ligjor, ka ngelur formalitet; dhe Inspektoriati Shtetëror të Punës i mungon pavarësia.<sup>19</sup> Duke pohuar se këshillat e sigurisë në punë në nivel kompanie ekzistojnë në mënyrë formale në disa kompani publike dhe janë tërësisht inekzistente në pjesën më të madhe të kompanive private, KSSH-ja pranon edhe dështimin e sindikatave ekzistuese në rolin e tyre kyç të mbrojtjes së shëndetit të punëtorëve/ëve. Së fundmi, me më pak se 100 inspektorë<sup>20</sup> për mbi 160 mijë subjekte ekonomike, aksidentet e shumta në punë, shpesh me pasojë humbje jetësh, janë vetëm se kronika vdekjesh të paralajmëruara.

Gjithashtu, pavarësisht të dhënave zyrtare për rënie të papunësisë përpara pandemisë, është e qartë se këto shifra "fshehin" një situatë alarmante në botën e punës: numër i lartë (12.7%) i të dekurajuarve, të cilët kanë ndërprerë përpjekjet për të gjetur një punë (INSTAT 2020c), nivel i

lartë vetëpunësimi (35.4%) si e vetmja mënyrë mbijetese, e një numër i konsiderueshëm punëtorësh në punësim part-time (20%) apo në kontrata të përkohshme (11%) (World Bank 2018: 10-13). Një pjesë e konsiderueshme e atyre që punojnë janë në punësim informal, i cili ka ardhur në rritje dhe në 2018 vlerësohej të ishte në nivelin 37% (OECD 2020). Gratë janë veçanërisht të prekura nga punësimi informal; në 2014 ato ishin 1.7 herë më të predispozuar të punonin pa pagesë në sipërmarrjet familjare (INSTAT 2014).

Ndërkaq, punëtorët/et shqiptarë/e punojnë për të jetuar në varfëri. Ata/o kanë pagat më të ulëta në Europë si në terma absolute, ashtu edhe përsa i përket fuqisë blerëse (Monitor 2018). Kështu, 59% e të varfërve punojnë dhe 76% e këtyre janë në punë me pagesë (Ministry of Social Welfare and Youth 2014). Në veçanti, të vetëpunësuarit/ at dhe punëtorët/et part-time (shpesh të punësuar/a në mënyrë informale) konsiderohen të jenë më shumë të rrezikuar për të qenë të varfër/a, pasi të ardhurat e tyre janë më të ulëta se mesatarja dhe ata/o janë shpesh të përjashtuar/a nga sistemi i mbrojtjes shoqërore (World Bank 2018: 10), i cili është gjithashtu në gjendje të mjeruar. Kështu, sipas Organizatës Botërore të Punës: niveli i shpenzimeve për mbrojtjen sociale në raport me PPB (përjashtuar shëndetin) është 9%, çka është shumë më poshtë se mesatarja 16.5% e Europës dhe Azisë Qendrore dhe 12.5% e Europës Lindore; vetëm 6.9% e të papunëve marrin pagesë për papunësinë kundrejt 56.5% në Europën Lindore dhe 42.5% në Europë dhe Azinë Qendrore; Shqipëria shpenzon vetëm 0.2% të PPB në mbështetje sociale për njerëzit në moshë pune; përqindja (77%) e të moshuar/ave që marrin pension në Shqipëri është shumë më poshtë se mesatarja (95.2%) në Europë dhe Azinë Qendrore dhe (93.8%) në Europën Lindore (ILO 2017: 26-164).

Është tashmë fakt i pranuar gjerësisht se jo vetëm varfëria, por edhe pabarazia janë të lidhura ngushtësisht me problemet strukturore në botën e punës (ILO 2015; OECD 2017). Më specifikisht për rajonin tonë, një studim i fundit i *Friedrich Ebert Stiftung* thekson se tregjet e punës janë arsyeja kryesore për pabarazinë dhe se pabarazia në të ardhura shkaktohet veçanërisht nga papunësia, mospjesëmarrja në aktivitete ekonomike, puna informale dhe në kushte prekariati, por edhe nga mungesa e

19 Intervistë me Presidentin e Konfederatës së Sindikatave në Shqipëri Dita Botërore për sigurinë në punë. Aksesuar më 12 tetor 2020, nga: [https://www.youtube.com/watch?v=w9QYx\\_D7\\_Fk&fbclid=IwAR-0Ga0ZoeIdcBuzDRSmAnWkoMaczr4GjPVAYc3AaAEf1qrNRmTlxQD-mQsNQ&app=desktop](https://www.youtube.com/watch?v=w9QYx_D7_Fk&fbclid=IwAR-0Ga0ZoeIdcBuzDRSmAnWkoMaczr4GjPVAYc3AaAEf1qrNRmTlxQD-mQsNQ&app=desktop)

20 Organigrama e inspektoriatit shtetëror të punës dhe të shërbimeve. Aksesuar më 15 Tetor 2020, nga: <http://inspektoriatipunes.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Organigrama-e-degeve-te-Inspektoriatit-f.png>

sistemeve të taksimit progresiv e dobësia e sistemeve të mbrojtjes sociale (FES 2018: 1). Në vitin 2018, më shumë se një në tre persona në Shqipëri ishte i varfër (World Bank 2020b: 37) e studime të ndryshme sugjerojnë nivele të larta të pabarazisë në vend (Eurostat 2020; Jusić 2018: 15).

Kjo situatë e rëndë varfërie e pabarazie, e cila po përkeqësohet akoma më shumë nga pandemia, është rezultat i drejtpërdrejtë i krizës së thellë të modelit zhvillimor të Shqipërisë. Qartazi, një ekonomi e vogël, e orientuar nga konsumi (78% e kërkesës së përgjithshme) (INSTAT 2020e: 2), i cili mbështetet nga remitancat,<sup>21</sup> e varur nga turizmi, e dominuar nga eksportet e produkteve me vlerë të ulët të shtuar dhe me bilanc negativ tregtar, është shumë më e ekspozuar dhe e dobët përpara krizave globale. Për shembull, gjatë krizës së Eurozonës, të paktën një person humbi punën në 27% të familjeve shqiptare, krahasuar me 18% të familjeve në Europë dhe Azinë Qendrore (World Bank 2015: 3). Në ndryshim nga kriza e Eurozonës, efektet e kësaj krize priten të jenë shumë më të forta, veçanërisht për shkak të tkurrjes së fortë të sektorit të turizmit dhe rënies së kërkesës globale për mallra si veshje/kepuce dhe minerale (me përjashtim të floririt) në tregjet globale. Kështu, Banka Botërore parashikon një ulje prej 37% të eksporteve (World Bank 2020e: 120).

Kriza e pandemisë do të rrisë papunësinë dhe do të hedhë akoma më shumë punëtorë/e në ekonominë informale. Në të njëjtën kohë, kriza do të përkeqësojë edhe më shumë presionin mbi pagat. Praktikën e uljes së pagave të raportuara gjatë pandemisë ka të ngjarë të vazhdojnë edhe më masivisht duke konsideruar presionin nga nivelet në rritje të papunësisë, por edhe faktin që shumica e punëtorë/eve janë të paorganizuar në sindikata reale që do të ishin në gjendje t'i mbronin ata/o. Ndërkaq, nivelet e remitancave nga jashtë, priten të ulen edhe më tej, ngjashëm me periudhën e krizës së Eurozonës ku remitancat ranë nga 14.4% e PBB-së në 2008 në 10% në 2013.<sup>22</sup>

Efekti i kombinuar i këtyre faktorëve do të rrisë akoma më

shumë varfërinë në vend, çka mund të sjellë, mes të tjerash, edhe rritje të trafikimit dhe të punës së fëmijëve. Siç paralajmërojnë edhe Kombet e Bashkuara, rezultatet e arritura në botë në luftën kundër punës së fëmijëve që prej vitit 2000, mund të fshihen tërësisht (United Nations 2020). Këto parashikime janë veçanërisht shqetësuese për rastin e Shqipërisë, e cila konsiderohet si një ndër vendet me risk të lartë të shfrytëzimit dhe trafikimit të fëmijëve (Reporter 2020c).

Përballë kësaj situatë dramatike, qeveria shqiptare duket të jetë jo vetëm e papërgatitur, por edhe pa vullnet politik për të reaguar. Për shembull, 87.5% e punës së fëmijëve në Shqipëri është e përqëndruar në bujqësi (US Department of Labor 2018). Lënia jashtë ndihmës qeveritare të këtij sektori, do të çojë në rritje të punës së fëmijëve. Gjithashtu, problemet me shpërndarjen e ndihmës financiare që u hasën gjatë pandemisë tregojnë se edhe për ato grupe qytetarë/esh e punëtorë/esh të konsideruar si përfitues legjitimë, qeverisë i mungojnë mekanizmat e duhur për të arritur tek ta, një tjetër problem i hershëm ky. Në të njëjtën kohë, qeveria refuzoi të ndihmojë punëtorë/et informale/e gjatë pandemisë, duke ia hedhur barrën për formalizim të marrëdhënieve të punës vetë punëtorë/eve (Reporter 2020c). Kështu, qeveria dështoi edhe një herë të marrë përgjegjësinë politike për prezencën e fortë të ekonomisë informale në vend. Është absurditet të mendohet që në një marrëdhënie të pabarabartë midis një punëtor/eje dhe pronarit në kushte normale, punëtor/i ja të jetë në gjendje t'i vendosë kushte për formalizim pronarit në kushtet e një krize të thellë në ekonomi dhe punësim. Ndërkohë, është e njëjta qeveri, e cila në shkelje të plotë të konventave ndërkombëtare të punës, mbyll sytë përpara shkeljeve flagrante të së drejtës për sindikalizim në organizata të pavarura dhe demokratike, çka do të ishte një ndër mekanizmat për të balancuar disi këtë marrëdhënie të pabarabartë. Këtu, rasti famëkeq i diskriminimit të sindikalistëve të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, i konfirmuar edhe nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Reporter 2020d), dhe i shkeljes së të drejtës së kësaj sindikate për kontraktim kolektiv është shembulli më tipik.

21 IMF. 2020. IMF Staff Concludes a Remote Staff Visit to Albania. Aksesuar më 13 tetor, nga: <https://www.imf.org/en/News/Articles/2020/07/01/pr20252-albania-imf-staff-concludes-a-remote-staff-visit>

22 World Bank data. Personal remittances, received (% of GDP) - Albania, aksesuar më 14 Tetor 2020, nga: <https://data.worldbank.org/indicator/BX.TRF.PWKR.DT.GD.ZS?locations=AL>

## 4

## NJË MODEL ZHVILLIMOR PËRTEJ KRIZËS SË COVID-19

Shqipëria ka nevojë urgjente për politika efektive në përbalimin e krizës së pandemisë, por sidomos në daljen nga kriza e modelit ekonomik të këtyre tri dekadave: një ekonomi e dominuar nga konsumi, i cili në një masë të madhe mbahet gjallë nga remitancat, eksporte me vlerë të ulët të shtuar, investime të huaja të ulëta, bilanc negativ tregtar, shkatërrim i sektorëve strategjikë dhe degradim i shërbimeve publike, papunësi, e sidomos punësim informal e nëpunësim, varfëri, pabarazi e korrupsion. Është ky model i dështuar që i ka shtyrë e vazhdon t'i shtyjë shqiptarë/et drejt emigrimit.

Përtej intensitetit të kësaj krize shumëdimensionale, Covid-19 shënon një mundësi historike për të ndërtuar një model zhvillimor, sukcesi i të cilit matet nga aftësia për të krijuar një shoqëri që kujdeset për më të dobët, një shoqëri ku realizimi i potencialit individual nuk kushtëzohet nga mundësitë ekonomike dhe ku zhvillimi ekonomik ecën në harmoni e jo në luftë me natyrën. Përpjekjet për një model të ri zhvillimor duhen kthyer në një projekt politik për të mobilizuar rezistencë popullore ndaj rikthimit tek modeli i dështuar i këtyre tri dekadave. Ky projekt politik bëhet akoma më i domosdoshëm duke pasur parasysh nxitimin e qeverisë Rama për t'iu kthyer "normales" së PPP-ve.<sup>23</sup> Propozimet e mëposhtme synojnë identifikimin e disa prej fushave kryesore, ku duhet realizuar një ndryshim thelbësor nga kursi i politikave ekzistuese.<sup>24</sup>

### 4.1 NDËRTIMI I NJË SISTEMI TË FORTË SHËNDETËSOR

Para së gjithash, Covid-19 është një krizë, e cila ka ekspozuar haptazi dobësitë strukturore të sistemit shëndetësor në Shqipëri. Mirënjohja për punonjësit/et e shëndetësisë përgjatë pandemisë duhet përkthyer në politika që i trajtojnë këta/o punonjës/e si hallka më e rëndësishme e një sistemi shëndetësor të fortë, në gjendje për t'u

përballur me kriza si Covid-19, e cila siç paralajmërojnë edhe epidemiologët nuk do të jetë e vetmja. Rritja e pagave dhe pagesat shtesë për punë me rrezik duhet të aplikohet menjëherë për të gjithë punonjësit/et e sistemit shëndetësor. Në të njëjtën kohë, duhet të sigurohet që këta/o punonjës/e të kenë në dispozicion mjetet e duhura të mbrojtjes personale. Përtej anës monetare, emigrimi masiv i punonjës/eve të shëndetësisë, por edhe niveli i dobët i shërbimit shëndetësor, reflektojnë demoralizimin e thellë të tyre. Ky demoralizim i ka rrënjët në mungesën e zërit në vendin e punës, në punësimin e personave pa ekspertizë në menaxhimin e sistemeve të shëndetit publik, dhe në reforma që e kanë injoruar tërësisht të drejtën kushtetuese për kujdes shëndetësor cilësor dhe të aksesueshëm. Më përgjithësisht, problemet e cilësisë së shërbimit, përfshirë edhe rastet e shkeljes së etikës profesionale në sistemin shëndetësor publik, reflektojnë normalizimin e praktikës së nxjerrjes së fitimit nga sëmundjet në klinikat private, ku e drejta për trajtim shëndetësor është transformuar në privilegj për ata/o që kanë mundësi financiare.

Forcimi i sistemit kërkon ndryshime serioze në politikat sektoriale. Ky ndryshim duhet të fillojë me një rritje të konsiderueshme të buxhetit për shëndetësinë. Me shpenzimet më të ulëta për frymë në shëndetësi në rajon, ku 50% e kostove për trajtim shëndetësor paguhet drejtpërdrejt nga xhepi i qytetarëve, krahasuar me 14.9% në Bashkimin Europian (World Bank 2020a: 2), Shqipëria është një ndër ato vende ku sëmundja kthehet në dënim me varfëri. Gjithashtu, përtej investimeve në spitale,<sup>25</sup> është i domosdoshëm forcimi i sistemit shëndetësor parësor, sidomos i qendrave shëndetësore në komunitet dhe adresimi i atyre që njihen si përcaktuesit shoqërorë të shëndetit (*social determinants of health*): forcim të shërbimeve higjieno-sanitare, akses në ujë të pastër, ushqim të shëndetshëm dhe banesa të përshtatshme.

Së fundmi, çdo lloj ndërhyrjeje do të dështojë keqazi pa demokratizimin real të sistemit shëndetësor. Kjo do të thotë, përfshirje aktive të punonjës/eve të shëndetësisë dhe qytetarë/eve në politikat për transformimin radikal të sistemit shëndetësor, uljen e ritmeve të emigracionit

23 Mapo. Buxheti i 2021: Rama dyfishon PPP për vitin e ardhshëm. Aksesuar më 25 Tetor 2020, nga: <https://gazetamapo.al/buxheti-i-2021-rama-dyfishon-ppp-per-vitin-e-ardhshem/>

24 Propozimet në këtë seksion kanë përfutur nga publikimet e diskutimet e shumta të bëra nga sindikatat në vendet në zhvillim si Afrika e Jugut dhe Filipinet si edhe kurset online të Global Labour University: "Post-Corona Starts Now", "Global Supply Chains in Times of Covid-19" dhe "Decent Work in Global Supply Chains".

25 Modeli i shërbimeve shëndetësore në Shqipëri dominohet nga shërbimet përmes spitaleve, që është i kushtueshëm dhe i papërshtatshëm për llojin e sëmundeve (World Bank 2020a).



të punonjës/eve të shëndetësisë dhe rritjen e cilësisë së shërbimit.

## 4.2 FORCIMI I SKEMËS SË MBROJTJES SOCIALE DHE EKONOMIKE

Përsa kohë pandemia nuk është nën kontroll, mbështetja ekonomike për grupet më të dobëta dhe të marginalizuara, përfshirë edhe refugjatët duhet të jetë objektiv primar. Është përgjegjësi e shtetit të sigurojë që barra e krizës të mos mbahet nga më të dobëtit në shoqëri. Në të njëjtën kohë, kjo mbështetje është kritike për të forcuar kërkesën e përgjithshme, si një mënyrë për të frenuar sadopak rënien ekonomike. Kjo është akoma më e rëndësishme kur konsiderohet niveli shumë i lartë i konsumit në ekonominë shqiptare. Mosmarrja e masave të menjëhershme, veçanërisht duke konsideruar rënien e sigurt të remitancave, do të vërë në lëvizje një spirale të rrezikshme: ulja e kërkesës do të çojë në ulje të prodhimit e në rritje më të madhe të papunësisë e varfërisë. Mbështetja për këto grupe specifike është një ndër mënyrat për të forcuar ekonominë vendase, veçanërisht duke pasur parasysh se në ndryshim nga të pasurit, të cilët shpenzojnë më shumë mallra luksi të importuara, shtresat e varfra konsumojnë më së shumti ushqime e mallra të prodhuara në vend duke dhënë një kontribut më të madh në ekonominë e vendit. Kjo konfirmohet edhe nga një studim i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i cili konkludoi se një rritje e të ardhurave të 20% më të varfërve është e lidhur me rritje më të madhe të PPB (Dabla-Norris et al. 2015: 4). Në kontrast, rritja e të ardhurave të 20% më të pasurve çon në fakt, në ulje të PPB në afat të mesëm. Pra, për të forcuar kërkesën e përgjithshme dhe zbutur sadopak krizën ekonomike, shpenzimet duhen bërë atje ku mendohet se paratë do të shpenzohen më shpejt dhe me prodhime vendi.

Skemat për mbështetje ekonomike duhet të forcohen si në shkallën e mbulimit, ashtu edhe në nivelin e pagesave. Që përpara pandemisë, rreziku për të qenë i/e varfër apo përjashtimi social prekte gati gjysmën e individëve (49%) në Shqipëri (INSTAT 2019: 2). Pandemia e ka përkeqësuar dhe do të vazhdojë ta përkeqësojë më shumë këtë krizë varfërie. Ndërkohë, niveli aktual i ndihmës (50% të pagës minimale) ka një efekt të papërfillshëm mbi zbutjen e varfërisë, veçanërisht duke pasur parasysh që paga minimale është gjithashtu në nivele shumë të ulëta. Një pagesë bazë (*universal basic income*) duhet siguruar për të gjithë njerëzit nën një nivel të caktuar të ardhurash. Skema duhet të jetë universale, pa kushte shtesë që zakonisht rezultojnë në përjashtimin e shumë njerëzve nga skema. Një tjetër problem që duhet adresuar është forcimi i bazës së të dhënave por edhe mekanizmat për të arritur lehtësisht tek grupet në nevojë. Zgjerimi i skemës dhe i bazës së të dhënave do të kërkojë edhe zgjerim të administratës shtetërore. Së fundmi, është shumë e rëndësishme që këto skema të hartohen në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të punëtorë/eve, përfshirë edhe ata informalë/e. Të gjithë këto hapa mund të shërbejnë për ngritjen, më në fund, të një sistemi gjithëpërfshirës dhe efikas të mbrojtjes shoqërore.

## 4.3 RITJJA E MBROJTJES PËR PUNËTORË/ET DHE TË DREJTAT E TYRE

Situata e pandemisë, ku pushimet nga puna dhe/ose uljet e pagave janë identifikuar nga vetë kompanitë si strategji për t'u përballur me krizën (Albania Investment Council 2020), kërkon masa shumë të forta nga ana e qeverisë për të frenuar sadopak ritmet e rënies ekonomike. Ashtu siç u diskutua më sipër, ulja e pagave në situatë krize, jo vetëm do të rrisë akoma më shumë varfërinë, por do të sjellë një përkeqësim të kërkesës së përgjithshme dhe rrjedhimisht të situatës së punësimit. Për këtë arsye do të jetë shumë e rëndësishme ndalimi me ligj i uljes së pagave dhe rishikimi sa më i shpejtë i pagës minimale, në mënyrë që ajo të luajë rolin e duhur për zbutjen e varfërisë dhe pabarazisë. Paga minimale mund ta luajë këtë rol vetëm nëse rritet substancialisht dhe kombinohet me forcimin e institucionit të kontraktimit kolektiv për të siguruar zhvillimin pozitiv të pagave. Duke pasur parasysh dominimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla e të mesme, objektiv duhet të jetë forcimi i kontraktimit kolektiv në nivel sektorial, dhe rrjedhimisht i themeleve të kontraktimit kolektiv: organizata të forta e përfaqësuese të punëtorë/eve dhe të punëdhënës/eve. Më përgjithësisht, kontraktimi në nivel sektorial duhet synuar në të gjithë sektorët e ekonomisë. Kjo do të jetë një mënyrë efikase jo vetëm për të hequr mundësinë e konkurrencës përmes uljes së pagave por edhe për të nxitur zhvillimin teknologjik, gjë që do të përshpejtonte transformimin strukturor të ekonomisë. Rritje e veçantë e pagave do të duhet për ata/o punëtorë/e të konsideruar esencialë/e gjatë pandemisë.

Ndërkohë, shteti duhet të ofrojë skema të cilat dekurajojnë aktivisht heqjet nga puna. Këtu mund të eksplorohehen skema si ndarje e punës (*job sharing*) midis dy apo tre punëtorë/eve, apo punë e shkurtuar (*Kurzarbeit*), ku shteti subvencionon për pjesën e shkurtuar të punës. Kjo është një skemë që ka rezultuar shumë e vlefshme në ruajtjen e vendeve të punës dhe rimëkëmbjen e ekonomisë gjatë krizës financiare në Europë. Shkurtimi i orëve të punës do të ishte një skemë veçanërisht e përshtatshme kur konsiderohet se punëtorë/et shqiptarë/e punojnë orë më të gjata (42.9 orë/javë) se punëtorë/et në vendet e tjera të Europës (Monitor 2018). Në çdo rast, punëtorë/eve që humbasin vendin e punës, iu duhet garantuar një skemë e plotë mbrojtjeje shoqërore.

Në të njëjtën kohë, shëndeti dhe siguria në punë duhet të mbetet prioritet kryesor duke pasur parasysh që vendet e punës janë bërë shpesh qendra të përhapjes së Covid-19. Në veçanti, punëtorë/et informalë/e e me kontrata afatshkurtra kanë më shumë gjasa të punojnë edhe kur mungojnë masat e sigurisë, duke qenë kështu më të rrezikuari/at për t'u infektuar nga Covid-19. Këtu nuk flitet për më shumë rregullore, por për gjetjen e formave më të mira për të siguruar zbatimin efektiv të masave të shëndetit dhe sigurisë në punë. Nga njëra anë, ka një nevojë urgjente për të forcuar Inspektoriatin Shtetëror të Punës, që të sigurohen inspektime masive dhe aplikimi



i masave të forta e të menjëhershme për mbrojtjen maksimale të punëtorëve/eve. Kjo do të kërkojë rritjen e numrit të inspektorëve dhe forcimin e kompetencave të tyre. Mosrespektimi i masave të sigurisë në punë nga pronarët duhet ndëshkuar si krim. Duke pasur parasysh që ndërmarrjet mikro e të vogla mund të kenë vështirësi për aplikimin e masave shpesh, qeveria do të duhet të ofrojë ndihmë të veçantë për sigurimin e mjeteve të nevojshme të mbrojtjes personale, si edhe për transportin e punëtorëve/eve gjatë pandemisë. Nga ana tjetër, siç u përmend edhe më sipër, duhet punuar sa më parë drejt një tjetër modeli të sigurisë në punë që ndryshon nga modeli aktual i fokusuar në ndjekjen e rregulloreve (*behavioural-based safety*), i cili rezulton gjithmonë në deklarimin e punëtorëve/eve fajtorë për aksidentet në punë. Eksperiencia botërore sugjeron se modeli më efikas është ai që siguron dhe përfshin punëtorët/kolektivisht në zbatimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë. Kështu, këshillat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë me përfaqësues të sindikatës ose punëtorëve/eve, kur nuk ka një organizim kolektiv në vendin e punës, duhen bërë funksionale në të gjitha vendet e punës. Këto këshilla duhet të hartojnë protokolle të veçanta për situatën e pandemisë duke përfshirë punëtorët/et në hartimin e rregullave. Ata duhet të evidentojnë punëtorët/et me probleme shëndetësore dhe t'i japin prioritet ruajtjes së shëndetit të tyre. Në të njëjtën kohë, punëtorët/et duhet të kenë të drejtën të refuzojnë punën nëse rregullat e sigurisë në punë nuk respektohen.

Efikasiteti i gjithë këtyre masave, është ngushtësisht i lidhur me krijimin e sindikatave të vërteta dhe demokratike që i japin zë punëtorëve/eve në vendin e punës. Në veçanti, shteti shqiptar duhet të sigurojë infrastrukturën e nevojshme shtetërore për të garantuar ushtrimin e së drejtës për sindikalizim dhe kontraktim kolektiv për të gjithë punëtorët/et pavarësisht statusit të punësimit. Kjo infrastrukturë përfshin lehtësimin e procedurave për njohjen e sindikatave në ligj e sidomos në praktikë. Për shembull, numri i nevojshëm i punëtorëve/eve për themelimin e një sindikate është shumë i lartë (20), veçanërisht kur konsiderohet dominimi i ndërmarrjeve të vogla e mikro në ekonominë shqiptare. Gjithashtu, procedura e regjistrimit të sindikatave, veçanërisht përfshirja e noterëve dhe e gjykatës, përbën një barrë të konsiderueshme financiare për sindikatat në formim. Kohëzgjatja e procedurës (60 ditë) është po ashtu problematike. Për më tepër, në praktikë, ka pasur raste kur procedura ka zgjatur nga 100 në 150 ditë, çka për sindikatat e reja mund të vërë në rrezik anëtarësinë themeluese. Në praktikë, gjithashtu, gjyqtarët kanë gjithë lirinë e veprimit për të zvarritur procesin e regjistrimit duke anuluar procedurën për mungesë dokumentacioni. Në të njëjtën kohë, pjesë e infrastrukturës për garantimin e së drejtës për organizim dhe kontraktim kolektiv është edhe vendosja e masave të ashpra që frenojnë diskriminimin e sindikalistëve/eve, si edhe ndërhyrjen në veprimtarinë e sindikatave dhe në procesin e kontraktimit kolektiv. Në veçanti, eksperiencia e Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës tregon qartazi hendeqet serioze ligjore të cilat lënë vend për shkelje të së drejtës për kontraktim kolektiv

në praktikë. Të gjitha këto masa do të jenë kritike për të siguruar mbrojtjen e punëtorëve/eve në kohë krize.

#### 4.4 MASA QË SHËNJESTROJNË GRATË NË VEÇANTI

Edhe pse masat e propozuara më sipër do të kenë efekt pozitiv edhe mbi gratë, ka gjithsesi nevojë urgjente për masa të veçanta për to. Ashtu si edhe në vende të tjera, efekti i pandemisë mbi gratë është shumë më i fortë, kjo veçanërisht sepse normat shoqërore i japin atyre barrën më të rëndë për përkujdesje në familje. Është puna e grave e cila, siç tregojnë edhe studime të shumta, subvencionon mungesën e infrastrukturës së nevojshme në shkollat dhe në sistemin shëndetësor. Covid-19 e intensifikoi edhe më shumë këtë punë pa pagesë, ku sipas raportimeve të UN Women Albania, gratë bëjnë 8 herë më shumë punë të papaguar se burrat<sup>26</sup>. Ky rol i caktuar nga shoqëria për gratë shkon përtej familjes, siç manifestohet edhe nga dominimi i grave në sektorë si shëndetësia, arsimit, punët me karakter përkujdesës ose higjieno-sanitar në banesa, hotele, apo restorante.<sup>27</sup>

Adresimi i këtyre problemeve kërkon masa politike në disa rrafshet, duke filluar nga rroga më të larta në sektorë të dominuar nga gratë, si arsimit dhe shëndetësia. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme aplikimi i orareve të punës më fleksibël për burrat dhe gratë në mënyrë që ata/o të kenë mundësinë të vendosin një ekuilibër më të mirë midis jetës familjare dhe punës. Lidhur me sa më lart, burrat dhe gratë duhet të kenë një numër të garantuar ditësh leje për t'u kujdesur për anëtarët e familjes. Këto ndërhyrje duhen kombinuar me forcimin e infrastrukturës për kujdesin për fëmijët, të moshuarit, dhe për personat me nevoja të veçanta. Sistemi i sigurimeve shoqërore duhet të njohë kontributin e grave në punën e papaguar të kujdesit për anëtarë të familjes jo vetëm përmes pagesës financiare, por edhe njohjes së kësaj pune për efekt të llogaritjes së kontributeve të pensionit. Përfitimet e shtatëzansit duhet të mbrojnë shëndetin e nënave dhe fëmijëve dhe leja e lindjes e paguar duhet të lejohet si nënat dhe baballarët të shpenzojnë të njëjtën kohë me fëmijët. Këto masa do të ndihmojnë në ndryshimin e normave shoqërore që i përcaktojnë grave përgjegjësinë për kujdesin në familje. Masa më të cilësuar (UN Women 2020b) duhen për gratë e dhunuara dhe fëmijët e tyre, për të adresuar kushtet që i mbajnë ato në marrëdhënie të dhunshme gjinore, si papunësia e varfëria.

26 UN Women Albania. Postim ne FB, i aksesuar më 15 Tetor 2020, nga: <https://www.facebook.com/unwomenalbania/photos/a.671774129534524/3218516704860241/>

27 Gazeta Si. Si ndikoi Covid-19 ne punesimin e grave ne Shqiperi? Aksesuar më 14 tetor 2020, nga: [https://gazetasi.al/si-ndikoi-covid-19-ne-punesimin-e-grave-ne-shqiperi/?fbclid=IwAR0zShBPGHs2731-NjiO6bsihaX0k9vVpQljB3ltGBWlxcpV96coJ\\_OWGj8k](https://gazetasi.al/si-ndikoi-covid-19-ne-punesimin-e-grave-ne-shqiperi/?fbclid=IwAR0zShBPGHs2731-NjiO6bsihaX0k9vVpQljB3ltGBWlxcpV96coJ_OWGj8k)

## 4.5 TRANSFORMIMI DHE DEMOKRATIZIMI I EKONOMISË

Përtej nevojës urgjente për t'iu përgjigjur krizës së thellë të papunësisë dhe varfërisë dhe për të stabilizuar disi ekonominë, është e rëndësishme të fillojë një diskutim serioz për të drejtuar investimet publike dhe politikave industriale drejt sektorëve që përmirësojnë jetët e njerëzve, rrisin punësimin dinjitoz, forcojnë rezistencën e vendit ndaj krizave dhe sigurojnë transformimin ekologjik të ekonomisë.

Projektet e investimeve publike mund të luajnë një rol kritik në këtë periudhë krize për të garantuar punësim dhe të ardhura, gjë që do të ketë një efekt të drejtpërdrejtë në forcimin e kërkesës së përgjithshme dhe rrjedhimisht ekonomisë e punësimit. Hapi i parë i domosdoshëm është ndalimi i menjëhershëm i projekteve të betonizimit të shesheve dhe bulevardeve dhe orientimi i investimeve drejt forcimit të shërbimeve publike dhe infrastrukturës shoqërore, si shkolla, kopshte, çerdhe, qendra kujdesi për personat e moshuar, etj. Sipas Konfederatës së Sindikatave Botërore, një investim në masën 2% të PBB në këta sektorë çon në një rritje të punësimit nga 2.4% deri në 6.1% (ITUC 2016). Shqipëria ka nevojë urgjente për këtë infrastrukturë, si edhe për një sistem modern të furnizimit me ujë, banesa sociale ekologjike dhe zgjerim e përmirësim të transportit publik. Projekti i zgjerimit dhe modernizimit të transportit publik, për shembull, është kritik për t'iu përgjigjur nevojave të punëtorëve/eve, të cilët/at janë veçanërisht të varur nga ky transport. Ky projekt është i domosdoshëm edhe për të ulur nivelet e larta të ndotjes së ajrit dhe zhurmave, të shkaktuara nga automjetet dhe kantierët e ndërtimit (Co-PLAN Institute for Habitat Development 2020). Është e qartë, tashmë, se kompanitë private të licensuara për të ofruar shërbimin e transportit publik kanë dështuar jo vetëm në sigurimin e një shërbimi cilësor dhe të aksesueshëm, por edhe në investimin në mjete më ekologjike. Ato i shkaktajnë shoqërisë dhe ekonomisë një dëm jo më pak të konsiderueshëm, përmes humbjes së kohës së vlefshme në familje dhe ekonomi.

Situata dëshpëruese e krijuar nga përfshirja e kompanive private në shërbimet publike, si edhe përhapja masive e korrupsionit në prokurimet publike (US Department of State 2020) kërkon jo vetëm sjelljen e këtyre shërbimeve nën kontrollin publik, por edhe demokratizimin e tyre përmes forcimit të rolit të punëtorëve/eve dhe qytetarëve/eve në menaxhimin e tyre (Xhafa 2013).

Gjithashtu, do të jetë veçanërisht e rëndësishme që projektet e investimeve publike të hartohen në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët të fushave të ndryshme, përfshirë planifikues urbanë, sociologë e ambientalistë. Së fundmi, është po aq e rëndësishme të sigurohet që punësimi në këto projekte publike të jetë i mirëpaguar, në mënyrë që pagat të luajnë realisht rolin e mbrojtjes nga varfëria.

Debati mbi politikat industriale është shumë më kompleks,

por duhet të fillojë duke qartësuar, se çfarë nuk duhet bërë më. Kështu, duhet ndërprerë vazhdimësia e një modeli që bazohet në avantazhin krahasues të krahut të lirë të punës. Kjo ndërprerje duhet bërë jo vetëm për shkak të rënies së kërkesës për këto mallra në tregjet ndërkombëtare, por edhe sepse konkurrenca përmes pagave të ulëta në prodhimin e veshjeve, për shembull, e vë Shqipërinë përballë vendeve si Bangladeshi, ku paga mujore për punëtorët/et e prodhimit të veshjeve është 95 USD/muaj<sup>28</sup> dhe Etiopia ku paga është 26 USD/muaj.<sup>29</sup> Në të njëjtën kohë, Shqipëria nuk mund as t'i afrohet numrave të forcës punëtore që ofrojnë këto vende - popullsia e Bangladeshit është gati 165 milionë dhe e Etiopisë gati 115 milionë. Është tashmë e qartë në të gjitha debatet serioze për zinxhirët globalë të prodhimit, se modeli ekzistues ka dështuar tërësisht në premtimin për industrializim dhe progres në zinxhirin e vlerës së shtuar përmes integritimit në prodhimin e veshjeve. Një integrim i bazuar në logjikën e avantazhit krahasues të pagave të ulëta e pa politika aktive qeveritare e kufizon potencialin e zhvillimit industrial, pasi ky lloj integrimi i shtyn vendet në zhvillim drejt prodhimeve me nivel të ulët sofistikimi dhe me përdorim intensiv të krahut të punës (Herr 2019).

Përballë intensifikimit të debateve për nevojën e ndryshimeve thelbësore në zinxhirët globalë të prodhimit në të gjitha forumet shkencore e politike, entuziazmi i kryetarit të bashkisë së Tiranës për mundësinë e zhvendosjes së prodhimit të veshjeve nga Azia në Shqipëri dhe përgatitjet për të rigjallëruar idenë e zonave industriale, që u japin prodhuesve të huaj lehtësira fiskale,<sup>30</sup> janë thellësisht shokuese dhe shqetësuese. Janë këto lloj "lehtësirash" për kompanitë, si edhe skemat e evazionit fiskal që i kanë shkaktuar shtetit shqiptar një borxh stratosferik dhe e kanë bërë shumë të veshtirë financimin e shërbimeve jetike për shoqërinë. Ajo çka duhet bërë është pikërisht e kundërta: dhënia fund këtyre skemave dhe rritja e pagës për punëtorët/et e fasonerive. Kjo do të mundësonte mbijetesën e vetëm atyre kompanive që janë në gjendje të konkurrojnë jo përmes shfrytëzimit brutal të punëtorëve/eve, por përmes investimeve në teknologji, çka do të vinte në lëvizje ndryshime strukturore në sektor (Xhafa 2016).

Ndryshime radikale duhen bërë edhe në industrinë nxjerrëse. Rastet si i Rafinerisë së Ballshit dëshmojnë qartazi se një shtet i dobët për të menaxhuar pasuritë natyrore në mënyrë direkte është akoma më i pafuqishëm, në mos pa

28 Sustainability agents. New Bangladesh Minimum Wage. Aksuar më 15 tetor 2020, nga: <https://sus-a.com/index.php/new-bangladesh-minimum-wage/2018/>

29 Ibid, (SUS), aksuar më 15 tetor 2020, nga: <https://sus-a.com/index.php/new-bangladesh-minimum-wage/2018/>

30 Shqiptarja.com. COVID-19 godet ekonominë, Veliaj në Repolitix: Të shohim anën pozitive, kompani nga Azia mund të vijnë në KASHAR. Aksuar më 15 tetor 2020, nga: <https://shqiptarja.com/lajm/covid19-godet-ekonomine-veliaj-ne-repolitix-te-shohim-anen-pozitive-kompani-nga-azia-mund-te-vijne-ne-kashar>

vullnet dhe i kapur,<sup>31</sup> për të siguruar zbatimin e kontratave me kompani private, të cilat kanë në dispozicion një armatë avokatësh të specializuar në hartimin e kontratave që favorizojnë korporatat. Këtu Shqipëria nuk përbën ndonjë përjashtim nga vende të tjera të pasura me burime natyrore, të cilat shfaqin nivele të larta korrupsioni dhe nivele të ulta demokracie, pasi grupe të pasura në shoqëri kanë stimuj të fortë për të zënë në dorë këto burime (Humprey et al. 2007). Vendimi i shtetit shqiptar për ta privatizuar rafinerinë dhe lidhur kontrata me kompani guacka (*offshore*), i ka kushtuar shumë shtrenjtë jo vetëm naftëtarëve/eve të Ballshit, të cilët kanë vite rrogash të papaguara, por edhe të gjithë ekonomisë e shoqërisë. Një deklaratë e fundit e Konfindustria e vlerëson dëmin e shkaktuar nga sektori i hidrokarbureve në mbi 10 miliardë lekë.<sup>32</sup> Për më tepër, këto industri kanë një impakt shkatërrimtar mbi mjedisin dhe komunitetin (Xhafa 2016) – një tjetër dështim fatkeq i politikës së këtyre tri dekadave. Pavarësisht retorikës, shteti shqiptar ka treguar mungesë totale serioziteti në çështjet mjedisore. Shembulli më i fundit është trajtimi preferencial që skema e Garancisë Sovrane i dha kompanive që operojnë në nxjerrjen e mineraleve dhe në tregtinë e naftës.

30 vite eksperimentesh të dështuara janë mëse mjaftueshëm për të hequr dorë nga ky model i specializimit në shfrytëzimin brutal të punëtorëve/eve dhe natyrës. Si një hap i parë, këto industri të cilat janë pjesë e sektorëve strategjikë të vendit duhen sjellë nën kontrollin publik, në skema menaxhimi që përfshijnë punëtorët/et dhe organizatat e tyre. Në ato kompani që kanë përfituar nga skema e Garancisë Sovrane, pjesëmarrja e punëtorëve/eve në menaxhimin e kompanive duhet të bëhet e deyrueshme.

Gjithsesi, duke pasur parasysh impaktin mjedisor të industrive nxjerrëse, shumë shpejt do të duhet të konsiderohet mbyllja graduale e këtyre industrive nxjerrëse. Kjo mbyllje duhet të jetë pjesë e procesit të transformimit ekologjik që adreson problemet e riintegritimit të punëtorëve/eve në vendin e punës dhe siguron kontrollin demokratik të energjisë. Kjo do të thotë që aktorët kryesorë të procesit duhet të jenë punëtorët/et dhe organizatat e tyre legjitime, komunitetet e kooperativat dhe jo kompanitë e mëdha private.<sup>33</sup>

Debati për një tjetër model zhvillimor do të duhet të angazhohet seriozisht me formulimin e politikave industriale që forcon ekonominë vendase, ndërsa merr seriozisht në konsideratë dinamikat e forcimit të tregjeve rajonale – një pasojë e pritshme nga situata e pandemisë. Për shembull, Shqipëria mund të përfitojë nga mundësi të

reja për zhvillimin bujqësisë dhe turizmit rajonal. Kjo do të kërkojë mbështetje të specializuar për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat dominojnë këta sektorë. Më përgjithësisht, këto ndërmarrje duhet të marrin përparësi për masat mbështetëse, pasi siç u përmend edhe më sipër, ato kanë një peshë të rëndësishme në ekonomi (99.8% të të gjitha ndërmarrjeve) dhe punësim (79.8% të të gjithë të punësuarve) (World Bank 2020c: 1). Ashtu siç e tregoi edhe pjesëmarrja e papërfillshme e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në skemën e Garancisë Sovrane, këto kompani kanë nevojë për paketa të specializuara me kushte të përshtatshme për nevojat e tyre.

Përtej mbështetjes për sektorët ekzistues, të cilët kanë efektin më të madh në punësim, theksi duhet të vihet në diversifikimin e ekonomisë, duke u fokusuar në sektorët me efekt më të fortë shumëfishues (*multiplier effect*) me lidhje të forta me sektorë të tjerë të ekonomisë (*backward and forward linkages*). Këtu përparësi i duhet dhënë formave të pronësisë, të cilat rrisin rolin e punëtorëve/eve në menaxhimin e ndërmarrjeve, si për shembull kooperativa të punëtorëve/eve.<sup>34</sup>

Politikat për diversifikimin e ekonomisë do të kërkojnë edhe adresimin e një tjetër problemi strukturor, atë të produkteve me nivel të ulët sofistikimi (World Bank 2020e: 119). Zhvillimi i produkteve më komplekse do të kërkojë zhvillimin e një force pune me nivel më të lartë ekspertize, çka paraqet një sfidë më vete në Shqipëri. Dobësia strukturore e forcave të punës është e lidhur ngushtësisht me nivelet e larta të emigracionit, por me edhe cilësinë e dobët të sistemit arsimor pas shkollës së mesme (World Bank 2020e: 78), çka dëshmon dështimin total të reformave të liberalizimit dhe komercializimit të arsimit të lartë. Adresimi i këtyre problemeve do të kërkojë hapjen e një debati të gjerë për sistemin arsimor, ku ligjet dhe politikat arsimore do të duhet të përgatiten me pjesëmarrjen e fortë dhe të drejtpërdrejtë të trupës universitare.

## 4.6 MOBILIZIMI I BURIMEVE FINANCIARE PËR TRANSFORMIMIN EKOLOGJIK TË EKONOMISË

Propozimet për forcimin e mbrojtjes sociale dhe rimëkëmbjen e transformimit mjedisor të ekonomisë kërkojnë financim masiv. Sigurimi i këtyre financave mund të bëhet përmes një sërë masash.

Së pari, kërkohen ndryshime radikale në sistemin e taksimit. Këto do të jenë kritike jo vetëm për të mobilizuar financa për projektet e investimeve, por edhe për të siguruar efektin barazues (*equalising effect*) që sistemi i taksave duhet të luajë, efekt i cili sipas vlerësimit të Bankës Botërore për Shqipërinë mbetet i vogël (World Bank 2020d). Një sistem i drejtë taksash i kombinuar me demokratizimin

31 Euronews. Grabitje me leje qeveritare. Aksesuar më 17 Tetor 2020, nga: <https://www.facebook.com/euronews.al/vid-eos/451439592497187/UzpfSTewNDkyOTg1MTEwNtk3NjoxODczNjA3OTk1Mjk1NDc/>

32 Gazeta Si. Hidrokarburet në Shqipëri me kompani të regjistruara në parajsa fiskale. SPAK të merret me ARMO-n. Aksesuar më 15 tetor 2020, nga: <https://gazetasi.al/hidrokarburet-ne-shqiperi-me-kompani-te-regjistruara-ne-parajsa-fiskale-spak-te-merret-me-armo-n/>

33 Për më shumë shiko TUED: <http://unionsforenergydemocracy.org/>

34 The Cleveland Model. Aksesuar më 18 Tetor 2020, nga: <https://community-wealth.org/content/cleveland-model-how-evergreen-co-operatives-are-building-community-wealth>

e vendimmarrjes për planet e investimeve, ngjashëm me skemat e famshme të pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e buxheteve (*participatory budgeting*) në Brazil e tjetërkund (Xhafa 2013), do të ulë nevojën për spektakle bamirësie, të cilat çenojnë rëndë dinjitetin njerëzor.

Sistemi aktual ka një sërë hendeqesh, adresimi i të cilave do të zgjerojë dukshëm hapësirën fiskale. Për shembull, të ardhurat nga tatimet dhe taksat në Shqipëri zunë 27.1% të PPB në 2019 (World Bank 2020b: 37) përkundrejt mesatares 40.1% në Bashkimin Europian (Eurostat 2019). *Panama Papers* hodhën dritë mbi tentakulat e skemës së evazionit fiskal në Shqipëri, jo çuditërisht të lidhur mes sektorëve të tjerë edhe me naftën.<sup>35</sup> Është e paqartë se çfarë ndodhi me investigimin e nisur me urgjencë nga qeveria për këtë çështje. Ndërkaq, qeveria shqiptare nuk aplikon taksa mbi pasurinë neto (Deloitte 2020), e cila sipas llogaritjeve bazuar në *Credit Suisse Global Wealth Databook* arriti në 70 miliardë USD në 2019 (ALTAX 2020). Sipas të njëjtit burim, 4% e të rriturve në Shqipëri (ose 89 mijë vetë), kanë një pasuri mbi 100 mijë USD e nga këta, 2,250 persona kanë pasuri mbi 1 milion USD. Gjithashtu, në 2019, qeveria Rama uli taksat mbi dividendët nga 15% në 8% me efekt prapaveprues, skemë e cila vlerësohet të ketë ulur taksat e paguara nga korporatat me dhjetëra miliona euro (Reporter 2018).

Një propozim solid për një skemë taksimi efektive do të duhet të zhvillohet bazuar në një analizë serioze të të gjithë mangësive në sistemin aktual, si edhe duke konsideruar propozimet e ndryshme që po debatohen në nivel ndërkombëtar për një sistem më të drejtë taksash (Tax Justice Network 2020). Disa prej këtyre propozimeve përfshijnë:

- Aplikimin i një takse solidariteti për të siguruar që barra e krizës të shpërndahet sipas mundësive. Kjo mund të behet përmes taksimit të pasurisë së më të pasurve, si p.sh i 4% më të pasurve në Shqipëri që kanë një pasuri mbi 100 mijë USD. Për super të pasuri/at, për shembull ata me pasuri mbi 1 milion USD, duhet aplikuar një nivel më i lartë takse;
- Një sistem taksimi progresiv që përfshin ndërprerjen e taksave indirekte si TVSH-ja, e cila ka tendencën të prekë më shumë të varfëri/at;
- Rritjen e nivelit të taksimit të drejtpërdrejtë mbi personat me të ardhura të larta dhe bizneset më fitimprurëse; dhe rritjen e taksave;

- Të paktën në të njëjtin nivel që taksohen të ardhurat nga puna;
- Për pasuri të akumuluar nga qeratat, trashëgimia dhe të ardhurat nga investimet;
- Përfshirja e kompanive që janë përfshirë në skema të evitimit të taksave nga skemat e ndihmës qeveritare;
- Masa të rrepta për kompanitë dhe individët që evitojnë të paguajnë ose paguajnë më pak taksa.

Së dyti, përveç masave të forta për të mbyllur shtigjet e evazionit fiskal, një tjetër instrument i rëndësishëm për transformimin ekologjik të ekonomisë janë bankat shtetërore të zhvillimit, të cilat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në financimin e këtij transformimi. Bankat qendrore mund të privilegjojnë bankat zhvilluese, çka do të thotë që një pjesë e rifinancimit të sistemit bankar kalon përmes këtyre bankave, por me interes të ulët. Nga ana e tyre, bankat zhvillimore mund të lëshojnë letra me vlerë me afat të gjatë, çka do t'i lejonte këtyre bankave financim afatgjatë me interes të ulët. Për shembull, në Bangladesh, ku 10% e popullsisë ka përfitur nga mbështetja e programeve të financimit ekologjik (*green financing*) të bankës qendrore për instalimin e paneleve diellore në banesa (Dikau dhe Ryan-Collins 2017:3). Është shumë e rëndësishme që bordet mbikëqyrëse të këtyre bankave zhvillimore të përfshijnë përfaqësues të punëtorëve/eve, punëdhënës/eve e organizatave mjedisore dhe ekspertë/e progresistë.

E së fundmi, qeveria shqiptare ka përfitur një numër të lartë donacionesh, grantesh dhe kredish. Për shembull, konferenca e donatorëve e shkurtit 2020 në Bruksel u zotua t'i akordonte Shqipërisë 1 miliardë Euro.<sup>36</sup> Gjithashtu, si pjesë e paketës së ndihmës për Ballkanin Perëndimor, Bashkimi Europian i ka akorduar Shqipërisë 4 milionë Euro si ndihmë e menjëhershme për sektorin shëndetësor dhe 46.7 milionë Euro për të mbështetur rimëkëmbjen shoqërore dhe ekonomike (OECD 2020: 7). Ndërkaq, FMN-ja ka aprovuar 190.5 milionë USD si ndihmë financiare dhe Komisioni Europian planifikon t'i japë Shqipërisë 180 milionë Euro si asistencë makro-financiare (ibid.). OECD raporton se Shqipëria po merr ndihmë edhe nga Turqia, Kina, Zvicra, Norvegjia, Hungaria dhe UNDP. Një transparencë e plotë për këto burime dhe mënyrën, si dhe sa janë përdorur, do të jetë shumë e rëndësishme për të siguruar burimet e nevojshme për të financuar masat urgjente për stabilizimin e ekonomisë si edhe politikën industriale për transformimin ekologjik të ekonomisë.

35 Panama Papers: The tentacles of tax evasion reach Albania. 2016. Aksesuar më 15 tetor 2020, nga: <https://cafebabel.com/en/article/panama-papers-the-tentacles-of-tax-evasion-reach-albania-5ae00af-8f723b35a145e6fbc/>

36 The World Bank in Albania: Overview. Aksesuar në datë 14 Tetor 2020, nga: <https://www.worldbank.org/en/country/albania/overview>



## REFERENCAT

**Albanian Investment Council.** 2020. *Gjetjet kryesore te Anketës "Covid-19 mbi bizneset". Sekretariati i Këshillit të Investimeve.*

**ALTAX.** 2020. *How well the welfare of individuals has increased in Albania and the Balkans and how it has been distributed?* Aksesuar më 13 Tetor 2020 nga: <https://www.altax.al/en/blog/647-how-well-the-welfare-of-individuals-has-increased-in-albania-and-the-balkans-and-how-it-has-been-distributed>

**Arqimandriti, Mirela; Llabani, Megi; Ljarja, Artemisa.** 2016. *Wage and Labour Conditions of Shoe and Garment Workers in Albania.*

**Co-PLAN Institute for Habitat Development.** 2020. *Mushkëri të gjelbra për qytetet tona. Fushata monitoruese për cilësinë e ajrit dhe zhurmave në stacionet e autobusave. Zona e monitorimit: Tiranë.*

**Dabla-Norris, Era; Kochhar, Kalpana; Suphaphiphat, Nujin; Ricka, Frantisek; Tsounta, Evridiki.** 2015. *Causes and Consequences of Income Inequality: A Global Perspective.* International Monetary Fund.

**Deloitte.** 2020. *International Tax Albania Highlights 2020.*

**Dikau, Simon and Ryan-Collins, Josh.** 2017. *Green central banking in emerging market and developing country economies.* New Economics Foundation.

**Eurostat.** 2020. *Enlargement countries – statistics on living conditions.* Aksesuar më 16 Tetor 2020 nga: [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Enlargement\\_countries\\_-\\_statistics\\_on\\_living\\_conditions#Income\\_distribution](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Enlargement_countries_-_statistics_on_living_conditions#Income_distribution)

**Eurostat.** 2019. *Taxation in 2018. Tax-to-GDP ratio up to 40.3% in EU.* Newsrelease. Aksesuar më 16 Tetor 2020 nga: <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/2995521/10190755/2-30102019-AP-EN.pdf/68739572-f06a-51e4-3a5b-86e660a23376>

**FES.** 2018. *Inequality in Southeast Europe.* Aksesuar më 16 Tetor 2020 nga: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/sarajevo/14451.pdf>

**Herr, Hansjörg.** 2019. *Industrial policy for economic and social up-garding in developing countries. Core Labour Standards Plus.* Friedrich Ebert Stiftung.

**Humphreys, M., Sachs, J.D., Stiglitz, J.E.** 2007. *Escaping the Resource Curse.* New York, Columbia University Press.

**International Labor Organization (ILO).** 2015. *Labour Markets, Institutions and Inequality Building Just Societies in the 21st Century.*

**INSTAT.** 2020a. *Rritja ekonomike tremujore. Shtator 2020.* Aksesuar më 16 Tetor 2020 nga: <http://www.instat.gov.al/media/7519/pbb-tr2-2020.pdf>

**INSTAT.** 2020b. *Anketa tremujore e forcave të punës, tremujori II 2020.* Aksesuar më 13 Tetor 2020 nga: <http://www.instat.gov.al/media/7429/atfp-t2-2020.pdf>

**INSTAT.** 2020c. *Tregu i punës 2019.*

**INSTAT.** 2020d. *Tregtia e jashtme e mallrave.*

**INSTAT.** 2020e. *Përmbledhje e treguesve të tregut të punës vlerësuar sipas Anketës Tremujore të Forcave të Punës, T2 2016 - T2 2020.* Aksesuar ne 30 Shtator 2020 nga: <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/#tab2>

**INSTAT.** 2019. *Matja e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri, 2017-2018.* Aksesuar ne 20 Tetor 2020 nga: <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-aanj/publikimet/2019/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-2017-2018/>

**INSTAT.** 2014. *Tregu i punës, Labour market 2014.*

**International Monetary Fund.** 2020. *IMF Staff Concludes a Remote Staff Visit to Albania.* Aksesuar më 12 tetor 2020 nga: <https://www.imf.org/en/News/Articles/2020/07/01/pr20252-albania-imf-staff-concludes-a-remote-staff-visit>

**ITUC (International Trade Union Confederation).** 2016. *Investing in the care economy. A gender analysis of employment stimulus in seven OECD countries.*

**Jusić, Mirna.** 2018. *Unequal Chances and Unjust Outcomes – Confronting Inequality in Southeast Europe.* Friedrich Ebert Stiftung. Aksesuar më 30 shtator nga: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/sarajevo/14452.pdf>

**Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.** 2020. *Employment and skills strategy 2014-2020.* Aksesuar nga shteti web. 12 tetor 2020: [http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/02/Albania\\_EMP-SKILLS-STRATEGY-February22.pdf](http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/02/Albania_EMP-SKILLS-STRATEGY-February22.pdf)

**Monitor.** 2020. *Call center fillojnë shkurtimet, çfarë po ndodh me të punësuarit.* Aksesuar në 5 Tetor 2020 nga: <https://www.monitor.al/call-center-sektori-qe-po-lufton-koronavirusin-permes-punes-nga-sh-tepia-2/>

**OECD.** 2020. *The Covid-19 crisis in Albania. Tackling Coronavirus (Covid-19) contributing to a global effort.*

**OECD.** 2017. *Labour market structure and wages: policies to reduce inequality in OECD countries.*

**Oxfam.** 2018. *The commitment to reducing inequality index 2018.*

**Porta Vendore.** 2020. *Recetat ekonomike në kohën e Covid-19, Shqipëria kundrejt rajonit.* Aksesuar më 30 shtator nga: <https://portavendore.al/2020/04/14/recetat-ekonomike-ne-kohen-e-covid-19-shqiperia-kundrejt-rajonit/>

**Reporter.** 2020a. *Koncesionarët e qeverisë, përfituesit e mëdhenj të fondit të garancisë sovraane.* Aksesuar më 5 shtator 2020 nga: <https://www.reporter.al/koncesionaret-e-qeverise-perfituesit-e-medhenj-te-fondit-te-garancise-sovrane/>

**Reporter.** 2020b. *Raporti: Fëmijët në Shqipëri, të rrezikuar nga shfytëzimi dhe trafikimi.* Aksesuar më 16 Tetor 2020 nga: <https://www.reporter.al/raporti-femijet-ne-shqiperi-te-rrezikuar-nga-shfrytëzimi-dhe-trafikimi/>

**Reporter.** 2020c. *Kriza në punësim e shkaktuar nga pandemia mund të jetë afatgjatë.* Aksesuar më 16 Tetor 2020 nga: <https://www.reporter.al/kriza-ne-punesim-e-shkaktuar-nga-pandemia-mund-te-je-te-afatgjate/>

**Reporter.** 2020d. *Vendimi i Komisionerit: Albchrome i shkarkoi minatorët për shkak të angazhimit sindikal.* Aksesuar më 4 Nëntor 2020 nga: [https://www.reporter.al/vendimi-i-komisionerit-albchrome-i-shkarkoi-minatorët-per-shkak-te-angazhimit-sindikal/?fbclid=IwAR29EOd-vEjje\\_pNEm95J5519gH9icFaesYb1586Oq7PxhwPCG6XCcpacp0U](https://www.reporter.al/vendimi-i-komisionerit-albchrome-i-shkarkoi-minatorët-per-shkak-te-angazhimit-sindikal/?fbclid=IwAR29EOd-vEjje_pNEm95J5519gH9icFaesYb1586Oq7PxhwPCG6XCcpacp0U)

**Reporter.** 2018. *Korporatat shqiptare mund të përfitojnë dhjetëramilione euro ulje taksash.* Aksesuar më 16 Tetor 2020 nga: <https://www.reporter.al/korporatat-shqiptare-mund-te-perfitojne-dhjetëramilione-euro-ulje-taksash/>

**Tax justice network.** 2020. *Progressive tax measures to realize rights.* Aksesuar më 16 Tetor 2020 nga: <https://www.taxjustice.net/2020/06/11/covid-19-progressive-tax-measures-to-realize-rights/>

**United Nations.** 2020. *Child labour gains since 2000 'could be wiped out by COVID', UN warns.* Aksesuar më 15 tetor 2020 nga: <https://news.un.org/en/story/2020/06/1066172>

**UN Women.** 2020a. *The impact of Covid-19 on women's and men's lives and livelihoods in Europe and Central Asia: preliminary results from a rapid gender assessment.*

**UN Women.** 2020b. *Voices of women's organizations on COVID-19: April 2020 sub-regional consultations.*

**US State Department.** 2020. *2020 Investment climate statements: Albania.* Aksesuar më 25 tetor 2020 nga: <https://www.state.gov/reports/2020-investment-climate-statements/albania/>

**US Department of Labor.** 2018. *Findings on the worst forms of child labor: Albania.* Aksesuar më 25 tetor 2020: [https://www.dol.gov/sites/dolgov/files/ILAB/child\\_labor\\_reports/tda2018/Albania.pdf](https://www.dol.gov/sites/dolgov/files/ILAB/child_labor_reports/tda2018/Albania.pdf)

**World Bank.** 2020a. *The economic and social impact of Covid-19: Health systems. Western Balkans Regular Economic Report.* No. 17. Spring 2020.

**World Bank.** 2020b. *Fighting Covid-19 Europe and Central Asia Economic Update.*

**World Bank.** 2020c. *Albania Credit Guarantee Scheme Assessment.*

**World Bank.** 2020d. *Poverty & Equity Brief: Albania.*

**World Bank.** 2020e. *Covid-19 and Human Capital – Europe and Central Asia Economic Update.* Fall 2020.

**World Bank.** 2018. *Western Balkans Labor Market Trends 2018.*

**World Bank.** 2015: *Albania World Bank Group Partnership Program Snapshot April 2015.*

**Xhafa, Edlira.** 2016. *The (impossible) development model of Albania: A labour perspective.* Monetäre Makroökonomie, Arbeitsmärkte und Entwicklung / Monetary Macroeconomics, Labour Markets and Development. Editors: Truger, Achim; Hein, Eckhard; Heine, Michael; Hoffer, Frank.

**Xhafa, Edlira,** 2013. *Alternative ways of organising public services and work in the public sector: What role for Public-Public Partnerships?* Working Paper. DFG-KollegforscherInnengruppe Postwachstums-gesellschaften

## MBI AUTORËT

**Edlira Xhafa** është Drejtore Ekzekutive e Akademisë Online të Global Labour University. Ajo ka përfunduar masterin në Politikat e Punës dhe Globalizimit në *Global Labour University* (Gjermani) dhe doktoraturën në Studime të Punës në Universitetin e Milanos, Itali. Prej vitit 2000, ajo është angazhuar me lëvizjen punëtore fillimisht në Shqipëri, e më pas në Filipine, Bangladesh, Kamboxhia dhe Burma. Ajo ka punuar në Organizatën Botërore të Punës (ILO) dhe sindikatën ndërkombëtare të arsimit (Education International), si edhe ka bashkëpunuar me sindikatat ndërkombëtare të shërbimeve publike (Public Services International) dhe të ndërtimit dhe pyjeve (Building and Wood Workers' International).

**Liri Kuçi** është e angazhuar në çështjet e organizimit punëtor e studentor, emancipimit shoqëror e barazisë gjinore në Shqipëri. Ajo ka përfunduar studimet Master për Teori Politike (2018) në Universitetin e Tiranës. Ka punuar si kryeredaktore (Historia lme 2019) dhe këshilltare politike për politikat sociale dhe gjinore në Qeverinë e Kosovës (2020). Aktualisht kontribuon si studiuese, e thelluar në të drejtat e grave dhe seksualitetit në kontekstin shqiptar, duke shkruar edhe për media ndërkombëtare.

## IMPRINT

Fondacioni "Friedrich Ebert" | Rr. "Kajo Karafili" Nd. 14, Hyrja 2 kati i I | Tiranë | Shqipëri

Pergjegjës:

**Stine Klapper** | Drejtoreshë e Fondacionit "Friedrich Ebert"

Tel: 00355 4 22 509 86

[www.fes-tirana.org](http://www.fes-tirana.org)

Koordinator programi:

**Genci Lamllari**

Publikimet e fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratimin me shkrim të FES

# BOTA E PUNËS NË KOHË PANDEMIE

## Krizë dhe mundësi



Covid-19 ka goditur rëndë botën e punës në Shqipëri, veçanërisht punëtorë/et informalë dhe prekariat, gratë e grupet e marginalizuara. Intensiteti i kësaj goditjeje i ka rrënjët në problemet strukturore të modelit zhvillimor të këtyre tri dekadave: një sistem shëndetësor i degraduar nga keqmenaxhim dhe reforma që nxisin logjikën e tregut në shëndetësi, një ekonomi e dominuar nga konsumi që mbahet gjallë nga remitancat, dhe e varur nga turizmi dhe eksportet e mineraleve dhe produkteve me vlerë të ulët të shtuar, një sistem mjerues i mbrojtjes sociale, papunësi e lartë, punësim informal dhe paga të ulëta. Ky model ka rezultuar në varfëri masive, pabarazi e korrupsion të thellë duke detyruar mijëra shqiptarë të emigrojnë. Përballë kësaj krize shumëdimensionale,



paketat e ndihmës qeveritare ishin të neglizhueshme. Përfituesit e mëdhenj rezultuan kompanitë e mëdha koncesionare gjatë qeverisë Rama.

Covid-19 shënon një mundësi historike për t'u mobilizuar rreth një projekti politik që synon transformimin e modelit zhvillimor për të shkuar drejt një shoqërie që kujdeset për më të dobët, ku realizimi i potencialit individual nuk kushtëzohet nga mundësitë ekonomike dhe ku zhvillimi ekonomik ndodh në harmoni e jo në luftë me natyrën. Shqipëria ka nevojë urgjente për një ndryshim radikal të kursit politik për të përballuar këtë pandemi, por sidomos për të dalë nga kriza e modelit të këtyre tri dekadave. Në afat të shkurtër, prioritare duhet të jenë forcimi i sistemit shëndetësor,



i mbrojtjes sociale dhe i të drejtave të punëtorë/eve pavarësisht statusit të punësimit. Këtu ata/o që u trajtuan si punëtorë/e esenciale duhet të marrin përparësi. Gjithashtu, është e domosdoshme aplikimi i masave të veçanta për gratë.

Përtej pandemisë, do të jetë i domosdoshëm orientimi i investimeve publike dhe politikave industriale drejt sektorëve, që përmirësojnë jetët e njerëzve, rrisin punësimin dinjitoz, forcojnë rezistencën e vendit ndaj krizave dhe sigurojnë transformin ekologjik të ekonomisë. Ky proces transformimi duhet të ndodhë paralelisht me demokratizimin real të ekonomisë dhe botës së punës përmes pjesëmarrjes së fortë të punëtorë/eve në kontrollin dhe drejtimin e ndërmarrjeve.

Për më shumë informacion:

<https://www.fes-tirana.org/al/publikime/>